



Prishtinë: 27.08.2020  
Kodi i ZRRE-së: V\_1282\_2020

## Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

### Duke u bazuar në:

- Nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, nenin 15 dhe 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK\_V\_2075\_06\_20**;
- Ankesa e konsumatorit e datës **22.07.2020**.

në seancën e mbajtur më datë 27.08.2020, nxori këtë:

### V E N D I M

- I REFUZOHET** ankesa e konsumatorit S.B. nga Malisheva me shifër të konsumatorit DPR – 90064866 si e pa bazuar, ndaj vendimit të Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRrE.
- II MBETET në fuqi** vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve nr. **ZRRE/DMK\_V\_2075\_06\_20** i datës **30.06.2020**.

### A r s y e t i m

Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) me datë 22.07.2020 ka pranuar ankesën e parashtruar nga konsumatori S.B. nga Malisheva, i cili ka kundërshtuar vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE si vendim i shkallës së parë për këto shkaqe: shkeljeve esenciale të dispozitave procedurale, vlerësimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të dispozitave materiale. Ndër të tjera, konsumatori pretendon se është e pamundur që të shpenzohen 700 € energji elektrike, dhe ka ngritur dyshime se me këtë faturim po tentohet që të mbulohen shpenzimet e energjisë elektrike për minoritetin serb. Më tej është thirrur në parashkrimin e borxhit, sipas nenit 360 par. 1 pika 1.1 të Ligjit për Marrëdhënie Detyrimore.

Konsumatori në ankesën e tij ka theksuar se kërkon nga Bordi i ZRRE-së që pezulloj vendimin e DMK-së me nr. ZRrE/DMK\_V\_2075\_06\_20, të datës 30.06.2020.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji në mbledhjen e mbajtur me datë 27.08.2020 ka analizuar të gjitha shkresat e lëndës të prezantuar nga palët në kontest, si dhe vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe pas kësaj ka vërtetuar se vendimi i DMK-së si vendim i shkallës së parë është vendim i drejtë dhe i bazuar në prova konkrete.

Në pretendimin e konsumatorit se është e pamundur që të shpenzohen 700 € dhe se me këtë faturim po tentohet që të mbulohen shpenzimet për minoritetin serb, Bordi i ZRRE ka vlerësuar këto pretendime si të pa baza dhe të pa qëndrueshme. Bazuar në analizën e përgjithshme të energjisë



elektrike, si dhe listave të leximit, konstatohet se konsumatori ka lexim dhe faturim të rregullt të shpenzimeve të energjisë elektrike. Krahasimi i shpenzimeve për periudhën kontestuese me periudhat e mëvonshme dhe të mëhershme, vërteton se konsumatori ka luhatur në shpenzimin e energjisë. Për këtë qëllim, Bordi i ZRRE ka bërë krahasimin e shpenzimeve të konsumatorit me dy njehsorët elektrik, nr.69077622 dhe njehsorin kontestues nr.73418242 për periudha të ndryshme kohore dhe se konstaton se konsumatori edhe me njehsorin e ri elektrik vetëm në periudhën 12/2018 ka shpenzim më të lartë 861 kWh/muaj, kurse në periudhat e tjera ka shpenzim të ulët. Bazuar në këto të gjetura, Bordi ka konstatuar se shpenzimi i energjisë elektrike (kWh) i faturuar në periudhën tetor 2017, paraqet shpenzim real të konsumatorit.

Bordi i ZRRE-së thekson se gjendja e shpenzimit të energjisë elektrike e evidentuar në procesverbalin e inspektimit nr.2123731 të datës 18.04.2017, përputhet me gjendjen e shpenzimit të energjisë elektrike të evidentuar në rrjedhën e energjisë elektrike të periudhës.

Bordi i ZRRE-së bazuar në transaksionet e konsumatorit dhe rrjedhën e energjisë elektrike konstaton se KEDS/KESCO kanë respektuar nenin 28 par. 1 dhe 2 të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji, ku thuhet se: *“1. Furnizuesi është i detyruar të sigurojë që konsumatorët të jenë të faturuar për energjinë e shfrytëzuar dhe për taksat e tjera, në përputhje me llojin e tarifës të dakorduar me konsumatorin (nëse është e aplikueshme). 2. Faturimi i energjisë së shpenzuar të zbatohet për çdo periudhë të faturimit duke u bazuar në të dhënat e lexuara nga njehsori dhe të mbledhura nga Furnizuesi ose Operatori i Sistemit për konsumatorët me tarifa të rregulluara në bazë të tarifave të miratuara nga ZRRE-ja dhe për konsumatorët e kualifikuar (me çmime të parregulluara), ashtu sic është rënë dakord në kontratën për furnizim”.*

Bordi i ZRRE, gjithashtu ka konstatuar se konsumatori në ankesën e tij nuk ka ofruar asnjë provë bindëse për të vërtetuar faktin se vendimi i DMK-së si organ i shkallës së parë nuk është vendim i drejtë dhe i bazuar në ligje dhe rregulla, por që i njëjti në ankesë vetëm se ka kontestuar vendimin e shkallës së parë në mënyrë të përgjithësuar pa ofruar prova të arsyeshme.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 27.08.2020 pas analizimit të gjithë asaj që u theksua më lartë, ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

- III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.



**Këshillë Juridike:** Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

**Bordi i ZRRE-së:**

---

Arsim Janova, u.d. kryesues

---

Besim Sejfiqaj, anëtar

---

Selman Hoti, anëtar

---

Izet Rushiti, anëtar

**Vendimi iu dërgohet:**

- KESCO-së, dhe
- Konsumatorit S.B. dhe
- Arkivit të ZRRE-së.